

# *Disa specifika të qeverisjes korporative në ekonomitë në tranzicion*

*Saxhide Mustafa\**

## **Abstrakt**

Qeverisja korporative sipas parimeve e standardeve të ekonomive të tregut të njohura si parimet e Organization of Economic Cooperation and Development (OECD), duhet të sigurojë rritjen e vlerës së aseteve të kompanive. Veç kësaj, ajo duhet të sigurojë një përfaqësim të drejtpeshuar të interesave të aktorëve (palëve të interesuara), para së gjithash, pronarëve, menaxhmentit dhe punonjësve. Një nga problemet qenësorë me të cilin ballafaqohen ndërmarrjet e reja private dhe ndërmarrjet e krijuara nëpërmjet privatizimit, është korporatizimi i tyre ose krijimi i strukturave moderne të qeverisjes korporative, të cilat siç trajtohen në këtë punim, kanë rëndësi parësore për rritje të këtyre kompanive, për qëndrueshmërinë e tyre, për qasjen në kapital dhe për atraktivitetin e tyre për investime. Arritja e këtyre standardeve në ekonomitë në tranzicion po provohet të jetë mjaft problematike sidomos në ekonomitë në tranzicion në Evropën Lindore dhe Evropën Juglindore. Diskutimet teorike dhe hulumtimet empirike konstatojnë se problemet nuk kanë të bëjnë aq me kornizën ligjore sesa me me zbatimin e tyre, e sidomos me mjedisin institucional dhe problemet që kanë këto shtete me zbatimin e ligjit si dhe me korrupsionin. Në këtë punim bëhet një vështrim i diskutimeve teorike për problemet specifike të qeverisjes korporative në këto vende dhe pastaj në bazë të burimeve sekondare dhe studimeve empirike në rastin e Kosovës, bëhet një analizë e shkurtër krahasuese e zhvillimeve në këtë fushë në Kroaci, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë.

---

\* Saxhide Mustafa, PhD Candidate, ligjëruese në Kolegjin "Riinvest", Prishtinë. Email: saxhide.mustafa@riinvest.net

Përfundimet e nxjerra nga kjo analizë dalin të jenë në linjë me diskutimet teorike.

**Fjalë kyç:** *Ekonomi në tranzicion, qeverisje, korporatë, borde, transparencë, llogaridhënie.*

## *Diskutime teorike*

Ekonomitë në tranzicion u ballafaquan, e disa ballafaqohen ende, me sfidat e transformimit të sistemit ekonomik për të servisuar nevojat e një ekonomie të hapur të tregut të aftë për t'u ballafaquar me konkurrencën dhe përmbushur nevojat sociale e ekonomike të këtyre shoqërive. Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore, zhvillimi i ndërmarrjeve private të krijuara pas kolapsit të sistemit socialist në Evropën Qendrore dhe Lindore, me një fjalë, konsolidimi i një sektori privat konkurrues, përbën faktorin qenësor për zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve dhe për ndërtimin e demokracisë. Një nga problemet qenësore me të cilën ballafaqohen ndërmarrjet e reja dhe ndërmarrjet e krijuara nëpërmjet privatizimit, është korporatizimi i tyre ose krijimi i strukturave moderne të qeverisjes korporative, të cilat siç trajtohen në këtë punim, kanë rëndësi parësore për rritjen e këtyre kompanive, për qëndrueshmërinë e tyre, për qasjen në kapital dhe atraktivitetin e tyre për investime.

Derisa për shembull vendet e Evropës Qendrore kanë shënuar arritje domethënëse në zbatimin e parimeve të OECD-së për qeverisje korporative, kjo nuk mund të thuhet për ato të Evropës Lindore dhe të Evropës Juglindore. Një çështje tjetër e rëndësishme në këto shoqëri është gjithashtu edhe qeverisja e ndërmarrjeve publike apo atyre shtetërore. Dobësitë që e kanë përcjellë procesin e privatizimit lidhur me pronësinë e koncentruar dhe deformimet në formën e oligarkëve, kanë vështirësuar ndërtimin e një strukture domethënëse në qeverisjen korporative. Një sistem i bazuar në marrëdhënie

reciproke të klasës së re të pronarëve me strukturat politike, reflektohet pastaj edhe në mënyrën se si qeverisen dhe funksionojnë korporatat, strukturat qeverisëse, mënyra e marrjes së vendimeve, ku më së shumti pësojnë transparenca dhe llogaridhënia, roli i aktorëve të interesuar, përgjegjësia sociale dhe parimet etike.

Në ndërtimin e ligjeve komerciale si dhe kornizës institucionale e ligjore për qeverisje të korporatave, më tepër ka pasur ndikim asistenca teknike sesa trashëgimia e mëparme legale (Pistor et al., 2000). Shumica e vendeve të Evropës Qendrore kanë aprovuar modelin kontinental, kurse vendet e Evropës Lindore dhe të Evropës Juglindore, kanë zbatuar të dy modelet, por duket se dominon modeli anglosakson.

Procesi i reformimit dhe i kalimit nga ekonomia e planifikuar në ekonomi të tregut mund të kundrohët në faza (etapa të ndryshme). Disa e shohin atë në tri etapa: (i) koha kur ende dominon struktura e vjetër e pronësisë dhe sistemi i vjetër (ii); koha kur sistemi i ri institucional është vendosur, por ende janë prezentë edhe elementet e sistemit të vjetër dhe, (iii) dominimi i institucioneve dhe praktikave karakteristike për një ekonomi të hapur të tregut (North, 1991). Ndërkaq, disa autorë të tjerë e kundrojnë këtë proces në dy faza: (i) shoku i marketizimit (marketization shock) dhe ristrukturimi reaktiv si dhe, (ii) privatizimi dhe ristrukturimi i thellë (Carlin, 2003).

Shoku i provokuar nga futja e liberalizimit të çmimeve edhe çmontimi i aparatit të ekonomisë së planifikuar dhe centralizuar, kalon nëpër problemet e rënies ekonomike, rritjes së papunësisë, emergjencës së iniciativës private dhe deri te vendosja e stabilitetit makroekonomik dhe fiskal. Në këtë fazë, përkundër gjithë problemeve, krijohet ndërlidhja midis performancës dhe qasjes në kapital, paraqitet dalja (bankroti) i firmave nga tregu dhe fillon krijimi i sektorit privat. Në këtë kontekst fillon edhe një lloj ristrukturimi reaktiv i

ndërmarrjeve, pasi ato duhet të marrin masa për të mbijetuar edhe në mungesë të nxitjeve dhe subvencioneve që u ofronte shteti. Varësisht nga kushtet dhe konteksti i dhënë, kjo fazë të disa vende ka qenë më e shkurtër (Evropa Qendrore dhe vendet e Baltikut), kurse te rasti i Bashkimit Sovjetik dhe disa vendeve të Evropës Lindore dhe Evropës Juglindore, është përcjellë edhe me gjendje kaotike, dezorientim dhe pasivizim total të ish-sektorit të ndërmarrjeve shtetërore. Faza e dytë, ajo e privatizimit dhe ristrukturimit të thellë, ndërlidhet me angazhimin e strukturave qeverisëse dhe menaxheriale në ndërmarrje që të marrin mbi vete përgjegjësinë për të operuar mbi pikën kritike të rentabilitetit dhe të sigurojnë rritje efeciente dhe një firmë të orientuar kah profiti (Carlin, 2003). Lidhur me këtë forma të pronësisë që burojnë nga privatizimi nga jashtë ose privatizimi nga brenda me MBO (Blerja e kompanive shtetërore nga menaxhmenti i tyre) dhe EBO (blerja e kompanive shtetërore nga të punësuarit), janë parë më shumë rëndësi relacionet në strukturën qeverisëse të korporatës. Konsiderohet se privatizimi nga jashtë ka qenë më efektiv në kontrollin e menaxherëve. Mungesa e tregjeve të kapitalit dhe mungesa e sistemeve transparente e standarde të raportimit financiar, ka favorizuar pronësinë e koncentruar. Gjithashtu, pronarët e jashtëm (investitorët e jashtëm) janë konsideruar më të orientuar kah profiti. Pastaj, pronësia e dominuar nga menaxherët është konsideruar më tepër e orientuar kah profiti sesa pronësia e dominuar nga punëtorët kur është fjala te privatizimi i brendshëm. Në përgjithësi, metodat themelore të privatizimit që kanë pasur të bëjnë me privatizimin masiv (shpërndarja e aksioneve falas, waucher etj) që ka prodhuar një pronësi të shpërndarë dhe privatizimi me shitje të aseteve ofertuesve dhe investitorëve privat (të jashtëm dhe të brendshëm) e që ka prodhuar pronësi më të koncentruar. Vlerësimet janë se kompanitë që pas privatizimit kanë rezultuar

me pronësi më të koncentruar, kanë qenë më të prira për ristrukturim të shpejtë (Marcincin & Wijnbergen, 1997).

Gjithsesi, për të parë ndikimet e tranzicionit në qeverisje korporative, mbetet me rëndësi që të shihet ndikimi i ndërrimit të pronësisë dhe ndikimi i strukturës së pronësisë në sjelljen e kompanive të caktuara. Megjithatë, një kohë të gjatë aranzhmanet dhe strukturat e qeverisjes korporative të kompanitë e privatizuara dhe ato të krijuara si kompani private, kanë mbetur jashtë vëmendjes së kërkimeve teorike dhe empirike. Këtu gjithsesi bëhet fjalë për krijimin e strukturave efikase të qeverisjes dhe kornizës institucionale që siguron transparencë dhe raportim korrekt financiar, procedura falimentimi, por edhe kornizë ligjore që mbron investitorët e pronarët, siguron balancë të interesave midis aktorëve të interesuar, e duke përfshirë edhe çështjen e 'disiplinimit' të menaxherëve. Megjithatë, konsiderohet se suksesi në ndërtimin e një kornize efektive të qeverisjes korporative të vendet në tranzicion, ka rëndësi jo vetëm për performancën e kompanive, por gjithashtu edhe për aftësinë e tyre konkurruese, raportin e tyre ndaj internacionalizimit dhe raporteve të tyre me shtetin (Estrin, 2002).

Kushtet e ndryshme bazike në fillim të tranzicionit dhe metodat e politikave të ndryshme të privatizimit, politikave ekonomike, duke përfshirë edhe kornizën ligjore e institucionale, kanë pasur efektet e tyre edhe në rrjedhat e modernizimit të qeverisjes korporative në vende të caktuara. Këto diferenca më tepër se të natyra e politikave, kanë një origjinë në kontekstin e përgjithshëm politik dhe thellësinë e reformave demokratike. Kështu, qeveritë e vendeve të Evropës Qendrore, vendeve të Baltikut dhe disave nga shtetet që kanë dalë nga ish- Jugosllavia (para së gjithash: Sllovenia dhe Kroacia), janë zgjidhur në kushte me legjitime të zgjedhjeve të lira, të bazuara kryesisht në sukseset e reformave, e që nuk

ishte rasti psh. me Rusinë, vendet e tjera të dala nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe shumica e vendeve të Evropës Juglindore (Esterin, 2002). Për nga karakteristikat e tranzicionit në Shqipëri dhe tranzicionit të vonuar, për shkaqe të njohura, në Kosovë, të dy këto ekonomi kanë më shumë karakteristika me grupin e dytë të vendeve. Konteksti i përmendur dhe përfshirja më e hershme e vendeve të grupit të parë në proceset e integritimit në BE, është reflektuar mes tjerash me një sukses më të mirë në ristrukturimin e ndërmarrjeve, performancën e tyre si dhe në zbatimin më të suksesshëm të qeverisjes korporative.

Një nga çështjet e rëndësishme që ndërlidhet me specifikat e qeverisjes korporative në ekonomitë e tranzicionit, ka padyshim lidhje me institucionet e brishta demokratike që nuk kanë kapacitete e as gatishmëri të elitave partiake në ato qeveri për të zbatuar ligjin (Crotty & Jobome, 2004). Kjo pastaj krijon një mjedis biznesor të trazuar, të pafavorshëm për biznes, ku zbatimi i kontratave biznesore ballafaqohet me sistemin gjyqësor joefikas dhe të ndikuar politikisht. Në këto kushte, një nga problemet kryesore është mbrojtja e investitorëve, përkatësisht mjedisit investues, i cili nuk ka mjaft nxitje për të zbatuar standardet e qeverisjes korporative. Në këtë situatë, te vendet ku përdoren shok terapitë me shpresë së ndërrimi i pronës vetvetiu do të injektojë një transfer edhe të institucioneve të ekonomisë së tregut, duke përfshirë edhe zhvillimin e qeverisjes korporative të bazuar në teorinë dhe e përvojat e institucionit “të agjencisë”, nuk u tregua e suksesshme në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Juglindore dhe Lindore (Crotty & Jobome, 2004). Stiglitz (1999) është i mendimit se aspektet e qeverisjes korporative në këto vende u nënçmuan për një kohë të gjatë. Në të vërtetë, doli se privatizimi dhe reformat përcjellëse u treguan të pasuksesshme në vendet e karakterizuara me institucione të dobëta, kapacitete

dhe gatishmëri të ulta për zbatim të ligjit dhe që është manifestuar me korrupsion dhe informalitet të lartë. Ndaj ka edhe mendime se sekuenca është dashur të jetë ndoshta forcimi i institucioneve e pastaj privatizimi. Konsiderohet se kjo sekuençë (privatizimi në kushtet e institucioneve të brishta e të dobëta) e krijoi edhe një vakum sa i përket qeverisjes korporative (Crotty & Jobome, 2004). Kjo madje ka stimuluar sjelljet e atyre që kanë përvetësuar blloqe kontrolluese të pronësisë që të përvetësojë rente publike si rezultat i një ristrukturimi destruktiv (Black et al., 2000). Ky ristrukturim destruktiv e ka gjenezën te privatizimi i manipuluar. Prandaj qeverisja e mirë korporative konsiderohet si një parakusht i ristrukturimit konstruktiv në ekonomitë në tranzicion (Crotty & Jobome, 2004).

Në vijim të këtij debati teorik janë shtruar edhe dilema se a thua transferimi i modeleve të qeverisjes korporative nga ekonomitë e zhvilluara të tregut ka qenë adekuat për të adresuar problemet si dominimi i aktorëve të brendshëm (insiders), përvetësuesit/pronarët e blloqeve të mëdha dhe institucioneve të dobëta, apo, është dashur që të zhvillohen modele që mbrojnë interesat e pronarëve më të vegjël dhe të aktorëve tjerë të interesuar, veçanërisht punëtorëve.

Lidhur me këtë, në fillim të këtij shekulli, në vitet 2000, zhvillohet edhe një diskutim lidhur me kontekstualizmin e modeleve të qeverisjes korporative, shpesh i konsideruar edhe si i influencuar nga i ashtuquajtimi 'konsensusi post uashingtonian' i cili konsensus u mor me problemet që solli zbatimi në bllok dhe i pakontekstualizuar e të ashtuquajturve terapi shoku (Crotty & Jobome, 2004). Pra, ishte një sugjerim që të shkohet përtej modelit aksionar/pronar-agjenci, duke marrë parasysh më tepër kushtet specifike të vendeve të caktuara lidhur me aspektin institucional, pronësor dhe biznesor, duke përfshirë këtu edhe kulturën biznesore.

Kështu për shembull Berglof dhe Pajuste (2002) konsiderojnë se metodat tradicionale të sjelljes së kompanive në raportin 'pronar-menaxher' në mjedisin e shumë vendeve të Evropës Qendrore e Lindore, u treguan të pasuksesshme në kushtet e pronarëve të rinj të mëdhenj (large block-holders). Kjo vlen edhe për mënyrën e fitimit (përvetësimin, take over) të tenderëve. Prandaj, modelet e përmendura u treguan joefektive si instrumente të disiplinimit. Ndaj ata angazhohen për forcimin e një kontrolli nga jashtë duke përfshirë edhe një bashkëpunim më të afërt të bankave dhe sistemit të gjykatave, një rregullim më të fortë dhe mbrojtje më të madhe të investitorëve, duke përfshirë këtu edhe rolin e kreditorëve.

Në të vërtetë, lidhur me vështirësitë e funksionimit të qeverisjes korporative në vendet e tranzicionit duket se problemi nuk qëndron te kodet, pasi që ato të shumtën pasqyrojnë kodet e praktikuara në ekonomitë e zhvilluara. Ato edhe janë përpiluar me asistencë të ekspertëve perëndimorë, konsulentëve të angazhuar. Me tepër se kaq, problemi qëndron te mjedisi biznesor dhe konteksti institucional dhe te nevoja për një evoluim të kulturës biznese. Një shembull ilustrues për këtë merret nga hulumtimi i organizuar nga Instituti Rus i Drejtorëve (RID, 2003). Kodi i Qeverisjes Korporative në Rusi ishte përgatitur me një asistencë të kualifikuar (OECD dhe Banka Botërore) dhe në kuadër të një procesi pjesëmarrës dhe konsultues me korporatat dhe palët/aktorët e interesuar dhe ishte aprovuar më 2001, RID bëri një anketë për të parë nivelin e zbatimit në vitin 2003. Derisa rreth 90% e kompanive kanë zbatuar Kodin në pjesët që kanë të bëjë me themelimin e bordeve dhe trupave, kjo nuk ngjet me pjesët e tjera. Vetëm 5% e tyre japin informacion lidhur me zbatimin e standardeve për strukturën e bordeve; vetëm 15% lidhur me standardet e shpërblimeve dhe komitetet e auditimit; mestarisht këto



korporata bëjnë transparente vetëm 7 nga 35 çështjet e rekomanduara (Fideorczuk, 2017).

Pra, kodet e qeverisjes korporative edhe tek ekonomitë në tranzicion duken shumë të mira në letër, por nuk kanë influencuar shumë te praktikat qeverisëse.

Një problem tjetër është edhe fakti se në kushtet kur ish-kompanitë shtetërore janë privatizuar nga ish-menaxherët e drejtorët, sistemi i bazuar në raportin 'principal - agjenci' nuk duket të jetë adekuat, që i bie sikur menaxherët të mbrohen nga vetvetja (Crotty & Jobomem, 2004).

### *Pasqyrë e shkurtër krahasuese*

Për të parë zhvillimet lidhur me qeverisjen korporative në ekonomitë në tranzicion, krahas Kosovës, do të japim një vështrim të shkurtër edhe për Bullgarinë, Kroacinë dhe Shqipërinë.

Kroacia dhe Bullgaria si anëtare të BE-së, tani kanë një histori tranzicioni që ndryshon pak a shumë për nga konteksti. Bullgaria pas një tranzicioni mjaft të egër në filltet e tij, të ngjashëm me Shqipërinë në vitet e hershme të saj, iu nënshtrua reformave të shpejta strukturore në kuadër të një procesi më të shpejtë të integritimit në BE. Kroacia ndërkaq me më shumë tipare të një vendi të Evropës Qendrore, por i dalur nga lufta, pati një zgjatje më të madhe të procesit të integritimit në BE. Në njëfarë mënyrë, tranzicioni në këtë ekonomi mund të quhet i rrumbullakuar në çështjet esenciale me integritimin e tyre në BE. Këto vende kanë adaptuar praktikat në legjislacionin e tyre sipas direktivave të Evropës për qeverisjen korporative.

Në Shqipëri dhe Kosovë ende vijon tranzicioni i stërzgatur, me probleme të ngjashme, por në një kontekst politik shumë të ndryshëm. Të dhënat janë marrë nga burime sekondare, kryesisht nga Raporti i European Bank for Research and

Development (EBRD) për Kroacinë e Bullgarinë, ndërsa për Shqipërinë edhe nga burime të tjera dhe kuptohet sidomos për Kosovën edhe nga dy hulumtime, anketime, njëri i bërë nga Instituti Riinvest dhe tjetri i bërë nga autorja për nevoja ekskluzive të këtij punimi. Në bazë të kësaj do të nxjerrim një krahasim midis këtyre vendeve bazuar në vlerësimet e EBRD (Country Assessment Report, 2017), duke e ndërlidhur këtë me disa karakteristika esenciale nga studimet e organizatave ndërkombëtare për mjedisin biznesor. Ndërkaq për Shqipërinë dhe Kosovën do të bëjmë edhe një krahasim më të thelluar.

Në këtë pjesë të studimit prezantohet një analizë s shkurtër krahasuese të qeverisjes korporative në Kosovë, Kroaci, Bullgari dhe Shqipëri. Së pari do të bëjmë një krahasim të vlerësimeve të EBRD për qeverisjen korporative bazuar në Country Reports (2017) për këto vende, duke i lidhur rezultatet e vlerësimit me disa vlerësime për mjedisin biznesor të publikuara nga organizata kredibile ndërkombëtare. Një krahasim i tillë duket me konsistent pasi që EBRD ka përdorur të njëjtën metodë lidhur me vlerësimin e zhvillimit të qeverisjes korporative për të gjitha vendet. Të dhënat e hulumtimeve, përkatësisht anketave për Shqipërinë dhe Kosovën, janë vështirë të krahasueshme duke marrë parasysh objektivat e ndryshme të këtyre studimeve, pastaj mostrat dhe pyetësorët. Megjithatë, një vijë gjenerale e disa fenomeneve mund të nxirret edhe nga këto studime.

Metodologjia e përdorur nga EBRD për vlerësimin e nivelit të qeverisjes korporative në vendet anëtare të saj konsiston në vlerësimin e kornizës ligjore dhe institucionale dhe zbatimit të saj duke e krahasuar me praktikën më të mira (parimet e OECD, institucioneve financiare, veçmas International Finance Cooperation-IFC, EBRD dhe BB). Metodologjia e përdorur është identike në secilin vend (EBRD, 2017). Për të vlerësuar kornizën dhe praktikën e qeverisjes korporative, janë zbërthyer në pesë

fusha, ku është dhënë një vlerësim përmbljedhës për këto aspekte:

- (1) Struktura dhe funksionimi bordeve;
- (2) Transparenca dhe zbulimi (publikimi);
- (3) Kontrolli i brendshëm;
- (4) Te drejtat e aksionarëve;
- (5) Aktorët (palët) e interesuara dhe institucionet.

Pastaj, secila nga këto fusha është ndarë në elemente përbërës të cilët janë vlerësuar në mënyrë numerike 1-5 dhe që përkojnë me vlerësimet cilësore nga 5- mirë e shumë mirë (ngjyra e gjelbërt e mbyllur), mesatare mirë - 4 (ngjyra e gjelbërt e hapur), korrekte 3 (ngjyra e verdhë), e dobët-2 (ngjyra e portokalltë) dhe 1 shumë e dobët (ngjyra e kuqe). Kështu për shembull vlerësimi për 'Strukturën dhe funksionimin e bordit' përbëhet nga elementet: përbërja, diversiteti gjinor, drejtorët (anëtarët) e pavarur, efektiviteti dhe përgjegjësia e bordit. Vlerësimet janë bërë në bazë të pyetësorëve në të cilët janë përgjigjur avokatë e juristë, rregullatorë, auditorë, kompani të mëdha të listuara dhe, bursat. Pyetësorët janë vlerësuar nga ekspertët e EBRD-së për qeverisje korporative dhe pastaj janë përpiluar raporte tekstuale dhe paraqitje grafike 15-20 faqe për vendet anëtare të EBRD-së. Më poshtë po japim tabelën përmbljedhëse pa u ndalur me tutje në sqarimet metodologjike të cilat mund të gjenden në EBRD (2017).

**Tabela 1:**

	Struktura dhe funksioni mi i Bordeve	Transpare nca dhe zbulimi (publikim i)	Kontrol li i brendshëm	Të drejtat e aksion areve	Aktorët/ palët e interesu ara dhe instituci onet
Kroacia	2/3	4	3	4	4
Bullgaria	2	3	2/3	4	2/3
Shqipëria	1/2	2	2	3	2
Kosova	1/2	3	2/3	2	2

Burimi: Corporate Governance Sector Assessment, EBRD, 2017

Nga ky vlerësim është karakteristik se të katër vendet më së keqi qëndrojnë lidhur me strukturën dhe funksionimin e bordeve dhe kjo ka të bëjë edhe me diversitetin edhe me prezencën e ekspertëve të pavarur edhe me vlerësimin e performancës. Gjithashtu edhe organizmi i kontrollit të brendshëm dhe auditit dhe për Bullgarinë, Shqipërinë e Kosovën, vlerësimi nuk është i mirë as për rolin e aktorëve të interesuar dhe rolin e institucioneve.

Shihet qartë se Kroacia ka bërë një përparim me të ndjeshëm, me probleme të caktuara te struktura dhe funksionimi i bordeve dhe kontrolli i brendshëm. Bullgaria ndonëse më herët e integruar në BE, këtu qëndron prapa. Në përgjithësi, Kroacia përkundër integritit më të vonshëm në BE, ka pasur një strukturë institucionale me të pjekur, një traditë më të fortë të organizimit të korporatave dhe në përgjithësi Kroacia ka qenë gjithnjë më afër Evropës Qendrore në shume aspekte, sesa Bullgaria. Shqipëria dhe Kosova kanë një vlerësim të ngjashëm,

me një vlerësim me të mirë për transparencën në Kosovë dhe për të drejtat e aksionarëve në Shqipëri.

**Tabela 2:**

	Rangimi në Doing Business 2017 *	Rangimi indexi i perceptimit për korrupsion **	Informaliteti ( % e firmave qe mendojnë se u konkurrojnë firmat joformale ***	Informaliteti – ekonomia joformale në % ****
Kroacia	51	57	48	30
Bulgaria	50	71	59	31
Shqipëria	65	91	40	33
Kosova	40	85	66	35

Burimi: \*World Bank, 2017, Transparency International, 2017,

\*\*\*Meduza, L., 2017, \*\*\*\*Riinvest 2012, 2015

Siç u pa edhe më lartë te diskutimet teorike, problemi themelor i qeverisjes korporative tek ekonomitë në tranzicion, veçanërisht në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore, nuk është te korniza ligjore, por në përgjithësi te forcimi i institucioneve të zbatimit të ligjit, me konkurrencën e lirë, luftimin e informalitetit dhe korrupsionit. Në një linjë me këto, konstatime janë pak a shumë edhe të dhënat e prezantuara në tabelën e mësipërme. Kroacia edhe këtu rangohet me së miri dhe më pas vjen Bullgaria e cila me disa tregues është më afër me Shqipërinë dhe Kosovën. Kosova dhe Shqipëria rangohen keq me diferenca jo aq të mëdha. Kosova ka bërë një kërcim të madh te indexi dhe rangimi në *doing business* më 2017. Një vit më parë ishte në vendin 60, ngjashëm me Shqipërinë. Se sa kemi këtu influence reciproke midis nivelit të qeverisjes

korporative dhe rangimit në fusha të caktuara, do të duhej të hulumtohej me thellë. Por, është evidente se në këtë nivel rangimi ndikon edhe niveli i qeverisjes korporative, por edhe situata në fushat për të cilat është bërë rangimi ku influencojnë dukshëm zhvillimet në qeverisjen korporative në vendet e caktuara.

Nëse tërheqim një paralele krahasuese midis Shqipërisë dhe Kosovës duke u bazuar në studime të kryera për Shqipërinë (Çipi, 2014; Dibra, 2014) dhe Kosovën (Riinvest, 2015; (Mustafa, 2018) si dhe vlerësimet e EBRD për të dyja vendet, do të mund të nxirreshin disa konstatime:

- Korniza ligjore me përjashtime të caktuar të zgjedhja e CEO (tek Shqipëria) dhe të drejtat e aksionarëve të vegjël të Kosova i përmbush standardet e OECD, por ka probleme serioze në zbatimin e tyre;
- Vlerësimi i EBRD-së është ngjashëm për Kosovën dhe Shqipërinë, me diferencë në nuanca ku Kosova fiton një përparësi të transparencës dhe kontrollit intern, kurse Shqipëria del më mirë në të drejtat e aksionarëve. Në elementet e tjera vlerësimi është i ngjashëm;
- Ngjashmëritë ekzistojnë edhe në madhësinë e bordeve, por sipas studimeve të cituara këtu në Shqipëri është një situatë më mirë në emërimin e anëtarëve të pavarur në borde si dhe në zgjedhjen e CEO nga bordi. Megjithatë, duket se në të dy vendet nuk ka procedurë, kritere dhe praktikë të ndërtuara për vlerësimin e performancës së CEO -ve;
- Në të dy vendet ka nevojë të kuptohet më shumë rëndësia e qeverisjes korporative në rend të parë për vetë korporatat, por edhe për shëndetin e ekonomive nacionale, aq më parë kur nuk ka mekanizma sforcues për zbatimin e Parimeve të OECD, përpos elementeve të këtyre parimeve që përfshihen në Ligje.

- Qëndron konstatimi, se përpos në sektorin e bankave, në të dy vendet zbatimi i parimeve standarde të qeverisja korporative sipas OECD dhe institucioneve tjera relevante është në fazat e hershme të zhvillimit.
- Në dyja vendet është evidentuar se ka mjaftë influencë negative të institucioneve qeveritare dhe politike, veçanërisht tek ndërmarrjet publike, por kjo vlen edhe në përgjithësi roli i institucioneve në mbështetje dhe promovim të qeverisjes së mirë, në zbatim të ligjit, të transparencës dhe llogaridhënies duhet të përmirësohet dukshëm.

### *Përfundime*

Vështirësitë e funksionimit të qeverisjes korporative në vendet e tranzicionit duket se problemi nuk qëndron te kodet, pasi që ato të shumtën pasqyrojnë kodet e praktikuarra në ekonomitë e zhvilluara. Ato edhe janë përpiluar me asistencë të ekspertëve perëndimorë, konsulentëve të angazhuar. Me tepër se kaq, problemi qëndron te mjedisi biznesor dhe konteksti institucional dhe te nevoja për një evoluim të kulturës biznese. Metodatat tradicionale të sjelljes së kompanive në raportin 'pronar- menaxher' në mjedisin e shumë vendeve të Evropës Qendrore e Lindore, u treguan të pasuksesshme në kushtet e pronarëve të rinj të mëdhenj (large block-holders). Kjo vlen edhe për mënyrën e fitimit (përvetësimit, take over) të tenderëve. Prandaj, modelet e përmendura u treguan joefektive si instrumente të disiplinimit të menaxherëve. Duket se zgjidhja është te forcimi i një kontrolli nga jashtë duke përfshirë edhe një bashkëpunim më të afërt të bankave dhe sistemit të gjykatave, një rregullim më të fortë dhe mbrojtje më të madhe të investitorëve duke përfshirë këtu edhe rolin e kreditorëve.

Analiza e shkurtër krahasuese e zhvillimeve në qeverisjen korporative në Kroaci, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë dëshmon

se një nga faktorët kryesorë të zhvillimit të një kornize domethënëse të qeverisjes korporative dhe të zbatimit të saj, është niveli i pjekurisë institucionale si dhe aftësisë dhe gatishmërisë së institucioneve për zbatimin e ligjit, barazisë para ligjit dhe barazisë në treg.

### *Referencat*

Bart, V. (1993). Macroeconomic Stabilization of Economies in Transition: Recent Experience, Preliminary Results and Some Lessons. *International Institute for Applied Systems Analysis*. Working paper.

Berglof, E. & Pajuste A. (2002). What do Firm disclose and why? Enforcing corporate governance and transparency in central and east Europe. *Oxford Review of Economic Policy*, Volume 21, No. 2. 178 - 197. DOI:10.92/oxrep/gri009

Bezo, Y. & Brahimi, F. & Dibra, Rr. (2015). Corporate Governance in Transition Countries. *Research Journal of Finance and Accounting*. Volume 6, No. 4. 104-111.

Black, B. Kraakman & R. Tarassova, A. (2000). Russian privatization and corporate governance: What went wrong? William Davidson Institute at University of Michigan, Business School, Working Paper 269.

Carlin, W., Schaffer, M., & Seabright, P. (2004). A Minimum of Rivalry: Evidence from Transition Economies on the Importance of Competition for Innovation and Growth. *Contributions in Economic Analysis & Policy*, Volume 3 No.1. DOI: <https://doi.org/10.2202/1538-0645.1284>.

Çipi, A. & Llaci, Sh. Ferriera, F. A. F. (2014). Current Situation of Corporate Governance Practices in Albanian Joint Stock Companies: A Delphi-based Approach. *Procedia - Social and Behavioral Science*. Volume 110, No. 24. 841-851.



Crotty, J., & Jobome, G. (2004). *Corporate Governance in Transition Economies: A Synthesis of the Evidence*. ISBN No: 1 85449 583 6, Avaliabe at:

[https://www.researchgate.net/publication/251181406\\_Corporate\\_Governance\\_In\\_Transition\\_Economies\\_A\\_Synthesis\\_Of\\_The\\_Evidence](https://www.researchgate.net/publication/251181406_Corporate_Governance_In_Transition_Economies_A_Synthesis_Of_The_Evidence).

Dibra, R. (2014). Management of Organizational Structuring Process and Corporate. *International Journal of Academic Research in Management*, Volume, 3. No. 1. 1-10.

Dibra, R. (2012). Corporate Governance In Transition Economies-Comparative Analysis Of Contemporary Corporate Governance Issues In Selected Of This Economies In South-Eastern Europe. The Albanian Case. *European Journal of Business and Economics*. Volume 7, 14 -18. DOI: 10.12955/ejbe.v7i0.130

Estrin, S. (2002). Competition and Corporate Governance in Transition. *The Journal of Economic Perspectives*, Volume 16, No.1. 101-124.

European Bank for Reconstruction and Development. (2017). *Corporate Governance in Transition Economies Croatia Country Report*. I disponueshëm në form elektronike:

<http://www.ebrd.com/what-we-do/sectors/legal-reform/corporate-governance/sector-assessment.html>. Qasja: Shkurt 2018

European Bank for Reconstruction and Development. (2017). *Corporate Governance in Transition Economies Bulgaria Country Report*. I disponueshëm në form elektronike:

<http://www.ebrd.com/what-we-do/sectors/legal-reform/corporate-governance/sector-assessment.html>. Qasja: Shkurt 2018.

European Bank for Reconstruction and Development. (2017). *Country Assesment Report*. I disponueshëm në form elektronike: <http://www.ebrd.com/what-we-do/sectors/legal-reform/corporate-governance/sector-assessment.html>.

reform/corporate-governance/sector-assessment.html). Qasja: Prill 2018

Fideorczuk, M. (2017). The Specificity of Bords of Directors in Russian Companies. *Journal of Management and Business Administration Central Europe*. Volume 25, No. 4. 96-118, DOI: <https://doi.org/10.7206/jmba.ce.2450-7814.209>

Marcincein, A. & Wijnbergen, S. (1997). The Impact of Czech Privatisation Methods on Enterprise Performance Incorporating Initial Selection Bias Correction. *Economics of Transition*. Volume 5, No. 2. 289 - 304.

<https://doi.org/10.1111/j.1468-0351.1997.tb00018.x>

North, D. (1991). Institutions. *The Journal of Economic Perspectives*. Volume, 5 No 1. 97-112.

Mustafa, S.(2018). *Qeverisja Korporative dhe Performanca e Kompanive në Kosovë*. Punim doktrature.

OECD.(1999). *Principles of Corporate Governance*. Paris. France. I disponueshëm në form elektronike:

[https://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=C/MIN\(99\)6&docLanguage=En](https://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=C/MIN(99)6&docLanguage=En)

Pistor, K., & Raiser, M., Gelfer. (2000). Law and Finance in Transition Economies. *Economics of Transition*, Volume 8, No.2. 325-368. <https://doi.org/10.1111/1468-0351.00047>

Riinvest Institute. (2013). *Të Paguash apo të mos paguash*. Prishtinë. Kosovë. I disponueshëm në form elektronike: [http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/Business\\_Informality\\_5mm\\_bleed\\_no\\_inside\\_Albanian\\_Final\\_v613964385731476692858.pdf](http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/Business_Informality_5mm_bleed_no_inside_Albanian_Final_v613964385731476692858.pdf)

Riinvest Institute. (2015). *Qeverisja Korporative në bizneset familjare*. Prishtinë. Kosovë. I disponueshëm në form elektronike:

[http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Qeverisja\\_Korporative\\_ne\\_Biznese\\_Familjare\\_ne\\_Kosove1474379290.pdf](http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Qeverisja_Korporative_ne_Biznese_Familjare_ne_Kosove1474379290.pdf)

Riinvest Institute. (2017). *Klima e bizneseve në Kosovë*. Prishtinë. Kosovë.

I disponueshëm në form elektronike:

[http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/May/19/Klima\\_e\\_Biznesit1495199071.pdf](http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/May/19/Klima_e_Biznesit1495199071.pdf)

Russian Institute of Directors. (2003). *Structure and Activities of Boards of Directors of Russian Joint-Stock Companies* Moscow: Russian Institute of Directors. Available at: // [www.rid.ru](http://www.rid.ru).

Stiglitz, J.E. (1999) *Wither Reform? Ten Years of Transition*. Keynote Address at Annual Bank Conference on Development Economics, World Bank, Washington DC, 28-30. April 1999. Available:[http://www.scirp.org/\(S\(lz5mqp453edsnp55rrgjt55\)\)/reference/ReferencesPapers.aspx?ReferenceID=1901497](http://www.scirp.org/(S(lz5mqp453edsnp55rrgjt55))/reference/ReferencesPapers.aspx?ReferenceID=1901497)

Transparency International.(2017). *Corruption Perceptions Index 2017*. Retrieved from [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2017](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017)

World Bank.(2017). *Economy Rankings*. Retrieved from <http://www.doingbusiness.org/rankings>

